



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVO

Oda e Infermierëve mëmë dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës  
Komora medicinskih sestara i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova  
Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo

REPUBLIC ARCHIVE

Nr. Prot.	488	Nr. i faq.	5	Data:	31.05.2019
Broj. prot.		Br. str.		Datum:	
Prot. no.		No. paga.		Date:	

DOLJNYNE KRISTINA KRISTINA



## Memorandum i Mirëkuptimit

Ndërmjet

**Shoqatës së Infermierëve të Urologjisë së Kosovës (SHIUK) dhe**

**Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK)**

---

Datë: 31.05.2019

**Palët Partnere dhe përfaqësuese të Memorandumit:**

**Shpresa Makolli – Kryetare e Shoqatës së Infermierëve të Urologjisë së Kosovës (SHIUK)**

**Dhe**

**Naser Rrustemi – Kryetar i Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK)**

**Tema: Marrëveshje Mirëkuptimi për Partneritet me Oden e Infermiereve të Kosovës**

**Përmbledhje :**

Shoqata e Infermiereve te Urologjise se Kosoves –është themeluar me qëllim të:

Ngritjes së bashkpunimit të infermierëve të Urologjisë mbrenda dhe jashtë vendit,avansimit profesional infermieror Urologjikë,dhe ngritjes së kualitetit të shërbimeve infermiore ndaj pacientit.

Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në to, aktivitetet e poshtëshënuara:

Në organizimin profesional vullnetar të të gjithë infermierëve të urologjisë së Kosovës pa dallim gjuhe ,nacionaliteti dhe konfesionit

Organizimin e kongresit të infermierëve të urologjisë së Kosovës një herë në vit,në të cilën ftohen të marrin pjesë me punimet e tyre edhe infermieret jashtë vendit,përveq ekspozës së punimeve shkencore në të merren edhe vendime tjera me interes për Urologjinë si dhe për mirëvajtjen e shoqatës.

-Organizimin e seminareve me qëllim edukativo-arsimor për infermierët e rinjë

-Bashkpunimin e ndersjelltë me shoqatat e ngjashme në vend dhe ne Botë.

-Organizimin e e udhëtimeve në simpoziume ,kongrese apo tubime shkencore në Botë.

Kyqjen në internet ,hapjen e postës dhe faqes së shoqatës për komunikim me të gjithë të interesuarit në vend dhe jasht vendit .

Realizimin e këtyre qëllimeve shoqata e parasheh prej te ardhurave të cilat grumbullohen nga antarësia ,donatorët e ndryshëm të vendit dhe të jashtëm ,nga revista shkencore,reklamat dhe të ngjajshme

Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person pa marrë parasysh racën, gjininë, orientimin seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën ose aftësitë fizike

Për t'i arritur këto synime, SHIUK- ka nevoj për mbeshtetje dhe bashkpunim me Oden e infermiereve te Kosoves ku veprimtaria e saj ka dëshmuar për transparencë, përfshirje të infermiereve në vendimmarrje dhe avancimin e profesional.

### **Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit**

Ky Memorandum i Mirëkuptimit ka për qëllim që zyrtarisht të konfirmojë bashkëpunimin/ koordinimin në mes të **Shpresa Makolli –Kryetare e Shoqatës se Infermierëve të Urologjisë së Kosovës (SHIUK)** dhe **Naser Rrustemi – Kryetar i Odës se infermierëve të Kosovës**

#### **Qëllime të tjera janë :**

Përcaktimi dhe ndarja e përgjegjësive mes palëve nënshkruese

Përcaktimin e personave të kontaktit në bashkëpunimin e mëtejme

Përcaktimin e datës kur ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e palëve nënshkruese të Memorandumit të Mirëkuptimit**

1. Kryetarja e SHIUK- së, do informojë OIKU –n, si partner lidhur me edukimin profesional,sipoziomet dhe kongreset e realizuara mbrenda dhe jashtë vendit, datën e mbajtjes se sipoziumeve,numrin e pjesemarrësve, bashkpunimin me shoqata te tjera.
2. Kryetarja e SHIUK- se do informojë OIKU –n, lidhur me projektet e reja .Organizatata partnere mbajnë përgjegjësinë dhe ekskluzivitetin e organizimit dhe implementimit të aktiviteteve të ndërlidhura me projektet e SHIUK-se
3. SHIUK- do kërkojë njohjen dhe akreditimin e prograve edukative nga OIKU dhe përkrahje finacjare ,po ashtu do të kërkojë njohjen e qertifikatave me pjesëmarrje ndërkombetare të takimeve infermiere urologjike dhe fushave të tjera infermiere.

4. SHIUK- promovon logot e gjithë organizatave partnere që janë pjesë e koalicionit dhe logon e OIK- ut.Gjatë zhvillimit të proceseve edukative palët mund të nënshkruajnë kontrata shtesë me të cilat do t'i rregullojnë marrëdhëniet e mëtejme për periodha të caktuara kohore
5. Palët zotohen që të jenë aktiv në procesin e edukimeve dhe takimeve profesionale infermierore

### **Rezultati i Arritjes së Kësaj Marrëveshjeje**

- Konfirmimi për pjesëmarrje në takime SHIUK dhe OIK
- Angazhimin e përbashkët për avancimin dhe edukimin e Infermiereve te Urologjise se Kosoves
- Ngritja e reputacionit të palëve nënshkruese

Hytja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi me datë 31.05.2019.


### **Ndryshimi dhe plotësimi**

Palët pajtohen me gjitha pikat e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit. Për ndryshimin dhe plotësimin eventual të kësaj marrëveshjeje palët janë të obliguara që të bëjnë njoftimin me shkrim tridhjetë (30) ditë para se ky ndryshim të ndodhë.

**Nënshkrimet e përfaqësuesve të kësaj Marrëveshjeje:**

Shpresa Makolli –Kryetare e

Shoqatës së Infermierëve të Urologjisë së Kosovës (SHIUK)



Naser Rrustemi – Kryetar i Odës së Infermierëve të Kosovës (OIUK)

